

Apel i albanologëve të huaj

Dr. Robert Elsie lexoi apelin e albanologëve në Seminarin Ndërkombëtar, Tiranë.

Ne studentë dhe studiues nga shumë vende të botës, të ardhur në Tiranë për të marrë pjesë në Seminarin e 17 Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare në gusht të vitit 1995, shprehim brengosjen tonë për situatën e mjeruar të popullsisë shqiptare në Kosovë. Nuk do të ketë paqe në Kosovë sa kohë që popullit të Kosovës do t'i mohohet liria dhe e drejta e tij për vetëvendosje.

Ne i bëjmë thirrje Komunitetit Ndërkombëtar të sigurojë që sanksionet kundër Serbisë dhe Malit të Zi të hiqen vetëm pas kthimit të lirisë dhe të demokracisë në Kosovë.

Ne i bëjmë thirrje Qeverisë serbe të ndryshojë politikën e saj ndaj shqiptarëve sa s'është vonë. Bashkëjetesa paqësore midis shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, në bazë të demokracisë, të barazisë dhe respektit të ndërsjellë, është akoma e mundur.

Ne u bëjmë thirrje gazetarëve nga e gjithë bota të thyejnë heshtjen dhe të informojnë opinionin botëror aktivisht mbi ngjarjet në Kosovë para se të krijohet në jug të Ballkanit një Bosnjë të dytë dhe akoma më të përgjakshme, thuhet në apelin e Albanologëve të huaj, pjesëmarrës në Seminarin Ndërkombëtar që po mbahet në Tiranë.

[botuar në / published in: gazeta *Zëri i Popullit*, Tirana, 29 gusht/August 1995]